

**STATUTI SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“SCIENTIFIC TRADE” sh.p.k.**

MORISCO FRANCESCO, lindur ne Bari me 19/10/1967, resident ne Capurso (Ba) rruga Elsa Morante n.4/A, me ID AR 9005326

TRILLO ALFONSO MARCO, lindur ne Bari me 14/12/1984, resident ne Bari rruga Vito Stifano n.8, me ID AS 0966428

Palët e sipërshënuara vendosin të nënshkruajnë Statutin e shoqërise me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës do të rregullohet nga Legjislacioni në shqiptar ne fuqi dhe nga ky Statut.

**KAPITULLI I**  
**FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA.**  
**Neni 1 – Forma**

Shoqëria **“SCIENTIFIC TRADE” sh.p.k.** ( këtej e tutje e quajtur “Shoqëria”) themelohet në formën e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe rregullohet sipas këtij Statuti.

Shoqëria ushtron aktivitetin e saj sipas Legjislacionit shqiptar në fuqi.

Statuti i shoqërisë është detyrimisht në përputhje me normativën shqiptare dhe është i integruar, për sa në to nuk parashikohen shprehimisht, nga legjislacioni shqiptar.

**Neni 2 - Emërtimi**

Emërtimi i shoqërisë është **“SCIENTIFIC TRADE” sh.p.k.** sh.p.k.

**Neni 3 – Objekti i Shoqërisë**

Shoqëria ka si objekt, kryerjen e aktivitetit kryesor në sektorin e pajisjeve shkencore për laboratorët e analizave, në veçanti:

- tregtim, importim, eksportim të produkteve dhe materialeve për laboratorë të analizave kimike, biokimike, klinike dhe mjeksore;
- projektim, prodhim, realizim, furnizim, magazinim, zbatim, instalim, riparim, menaxhim, mirëmbajtje dhe asistencë, si dhe tregtim me shumicë dhe me pakicë, importim dhe eksportim, dhënie me qera, në zyrë, dhe dhënie në përdorim të produkteve, sistemeve, aparaturave, software dhe hardware, impiantet dhe shërbimet informatike, sistemet informative të integruara, telematike dhe telekomunikacioni (ICT), programe për laboratorë elektronike, programe ekzistuese si në fushën menaxheriale ashtu dhe që specifikon: sisteme, aparatura dhe impiante teknologjike, struktura të informatizuara dhe aparatura informatike hardware – housing, telematike, multimediale, automatike, audiovizive; mobilim për laboratorë dhe zyra;
- proçedura menaxhimi dhe kontrolli të aparateve matëse telematike dhe telekomunikacioni, projektim, realizim dhe integrim sistematik i aparateve eksperimentale për kërkim publik dhe privat;



- realizim i sistemeve te informatizuara për komplekse spitalore dhe klinika; menaxhim i pacientit, kartela klinike të informatizuara, sisteme për departamentet, pajisje ndihmëse, sisteme menaxhimi administrativ, statistika shëndetësore;

- prodhim, mirëmbajtje dhe zhvillim i sistemeve integruese, programe dhe shërbime të krijimit dhe menaxhimit të website-ve dhe pajisjet e nevojshme për tregtim elektronik dhe gjithçka tjetër lidhur me menaxhimin, planifikim dhe organizimin me mjete informatike dhe aktivitete prodhues, shërbime telematike, ndërtim, instalim, menaxhim, përdorim dhe mirëmbajtje të rrjeteve telematike dhe të përmbajtjeve të tyre;

- realizim dhe menaxhim i kurseve të formimit dhe kualifikimit teknik-profesional, për privatët, ndërmarrjet dhe entet publike dhe private, kërkim stazhi te kompanitë të finalizuara me formim profesional të të rinjve, në sektoret e listuar më lart, të aktiviteteve didaktike për institute dhe ente të formimit, asistencë në lidhje me organizimin, menaxhimin dhe realizimin e projekteve të formimit profesional, prodhim dhe tregtim i sistemeve didaktike përfshirë dhe mësimin në distancë, përfshirë sistemet multimediale dhe audiovizivë të komunikimit;

- aktivitete të asistencës teknike kompanive në fazën e fillimit dhe zhvillimit.

Shoqëria mund të kryejë të gjitha aktivitetet lidhur me pasuritë e tundshme dhe të patundshme, juridike, ekonomike, tregtare dhe industriale që mund të jenë, sidoqoftë, pajisje të nevojshme, të dobishme dhe të mundshme për arritjen e objektit të shoqërisë, dhe në veçanti, mund:

- të marrë pjesë në kompani, ente ose ndërmarrje, qoftë në themelimin ose të themeluara; formojë aktivitete partneriteti me ente publike ose private për realizimin e projekteve që kanë të bëjnë me prezantimin, promovimin dhe zhvillimin teknologjik;

- marrë kredi qoftë edhe kredi hipotekare dhe, më në përgjithësi të aplikojë çdo formë financimi të promovuar nga bankat dhe strukturat e tjera financiare, të cilat pranojnë garancitë e përshtatshme në favor të të tretëve;

#### **Neni 4 – Selia e Shoqërisë**

**4.1** Selia e Shoqërisë ndodhet në Rruga Bogdaneve Pallati 25, Tirane

**4.2** Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër do të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

**4.3** Asambleja e Ortakëve mund të vendosë hapjen e degëve dhe zyrave të përfaqësisë në qytete të tjera brënda dhe jashtë Shqipërisë.

#### **Neni 5 - Kohëzgjatja**

**5.1** Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë deri me 31.12.2030

**5.2** Shoqëria mund të shkrihet para afatit ose kohëzgjatja e saj mund të shtyhet vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

### **KAPITULLI II**

#### **KAPITALI SHOQËRISË, KONTRIBUTET, NDARJA E AKSIONEVE TË SHOQËRISË DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE**

##### **Neni 6 – Kapitali i Shoqërisë**



6.1 Kapitali i Shoqërise është 136 leke

6.2 Kapitali i Shoqërisë përbëhet nga 2 (dy) kuota tërësisht e nënshkruar, e cila ka vlerën nominale sipas kontributeve të ortakut në Kapitalin e Shoqërisë, sipas Neni 7 (shtatë) të këtij Statuti:

#### **Neni 7 – Kontributet dhe Kuotat**

7.1 Kontributet në Kapitalin e Shoqërisë do të bëhen si më poshtë vijon:

ortakut MORISCO FRANCESCO i perket një kuote, me vlerë nominale e barabartë me 68 (leke) që i korespondojnë 50 % (pesëdhjetë) e Kapitalit të shoqërisë;

ortakut TRILLO ALFONSO MARCO i i perket një kuote, me vlerë nominale e barabartë me 68 (leke) që i korespondojnë 50 % (pesëdhjetë) e Kapitalit të shoqërisë;

#### **Neni 8 – Zmadhim i Kapitalit shoqëror**

8.1 Kapitali i shoqërisë mund të rritet pa kufizim në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

8.2 Në rastin e marrjes së vendimit për rritjen e Kapitalit Shoqëror, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë këtë rritje në proporcion me vlerën nominale të kuotave zotëruese të kapitalit.

Në rastin kur nuk mund të ushtrojnë këtë të drejtë kuotat e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë në proporcion me vlerën nominale të kuotës zotëruese të kapitalit.

#### **Neni 9 – Zvogëlim i Kapitalit të Shoqërisë**

9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë Kapitalin e Shoqërisë vetëm me anë të vendimit të Asamblesë së Ortakëve. Gjithësesi, Kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e kërkuar nga ligji.

9.2 Zvogëlimi i kapitalit mbështetet nga çdo ortak në proporcion me vlerën nominale të kuotës zotëruese të kapitalit.

#### **Neni 10 – Transferimi i Kuotave**


10.1 Kuotat mund të transferohen lehtësisht ndërmjet ortakëve.

10.2 Në rastin e heqjes dorë, qoftë me anë pagese apo falas në tërë kuptimin e fjalës, duke përfshirë aty edhe dhurimin e kuotave të shoqërisë subjekteve të ndryshme nga ortakët, kuotat duhet tu ofrohen për parablerje ortakëve të tjerë.

10.3 Në këtë rast ortaku i tjetërsuar duhet t'jua komunikojë me shkrim ortakëve të tjerë me anë të një letre rekomande me kthim përgjigje, vullnetin e tij për shitjen e tyre, duke përcaktuar cmimin, kushtet, modalitetin, emrin e blerësit dhe kushtet e shitjes. E drejta e parablerjes, sidoqoftë, duhet të referohet kuotës së plotë të ofruar për shitje.

10.4 Ortakët do të kenë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, nga marrja e letrës rekomande me kthim përgjigje, për t'i paraqitur ortakut të tjetërsuar vullnetin e tyre për të ushtruar ose jo të drejtën e parablerjes. Me skadimin e afatit të përcaktuar, e drejta e parablerjes në favor të tyre, konsiderohet e mbyllur.

10.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuota e ortakut të tjetërsuar do të ndahet midis tyre në proporcion me vlerën nominale të kuotës të kapitalit që secili prej tyre zotëron, përveç rasteve kur ka një



marrëveshje të ndryshe mes palëve. Në asnjë rast, ofruesi nuk duhet të pranojë ushtrimin pjesor të së drejtës së parablerjes.

10.6 Në rast se mungon ushtrimi i të drejtës së parablerjes, kuotat mund t'i transferohen tërësisht ose pjesërisht të tretëve, vetëm me miratim të Asamblesë së ortakëve.

10.7 Në rast të transferimit të kuotave trashëgimitarëve per *successione mortis causa*, u lejohet ortakëve të tjerë të shprehin pëlqimin ndaj ortakëve të rinj.

Në rast të mospëlqimi, kuotat mund t'u transferohen tërësisht ose pjesërisht palëve të treta, me miratim të Asamblesë me shumicë të thjeshtë.

### **KAPITULLI III**

#### **ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL**

##### **Neni 11 – Asambleja e Ortakëve dhe kompetencat përkatëse**

11.1 Organi vendimmarrës i shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.

11.2 Asambleja e Ortakëve gëzon kompetencat për të marrë vendime lidhur me çështjet e mëposhtme:

- ndryshimin e Statutit;
- emërimin dhe heqjen e administratorëve, të ekspertëve kontabël dhe të likuidatorëve;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e Kapitalit të Shoqërisë;
- transferimin e kuotave;
- shpërndarjen e fitimit;
- riorganizimin dhe shkrirjen e Shoqërisë;
- aprovimin e bilancit dhe të gjitha pikave të parashikura në këtë Statut dhe nga ligji përkatës.

##### **Neni 12. – Të drejtat e pjesëmarrjes në votim**

12.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, për të paraqitur opinionin e tij dhe për të shprehur votën e tij në përpjesëtim me kontributin e tij në kapitalin e shoqërisë.

12.2 Çdo ortak mund të përfaqësohet në Asamblesë e Ortakëve nga një person i tretë, jo ortak, i pajisur me një prokurë të thjeshtë, nëpërmjet së cilës do të mund të shprehë votën e tij.

12.3 Ortaku nuk mund të lëshojë asnjë prokurë për të votuar për një pjesë të kapitalit të tij, në qoftë se ai voton personalisht për pjesën e mbetur.

##### **Neni 13- Mbledhja e Asamblesë, Kuorumi dhe Vendimet**

13.1 Asambleja duhet të mbledhet të paktën një herë në vit brënda 120 (njëqind e njëzet) ditëve kalendarike nga mbyllja e vitit ushtrimor për aprovimin e bilancit, të raporteve të Administratorëve dhe /ose të Ekspertit Kontabël si edhe të inventarit.

13.2 Asambleja mund të thirret në çdo moment nga njëri nga Administratorët përveç se nga një ose disa ortakë të cilët përfaqësojnë të paktën 5% (pesë për qind) të kapitalit të shoqërisë. Asambleja duhet të mbledhet përmes dërgimit të një letre rekomande me njoftim marrje, e cila u dërgohet ortakëve, në adresat e shënuara në këtë Statut, dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar) të paktën 7 (shtatë) ditë përpara



mbledhjes së Asamblesë. Mbledhja duhet të përmbajë të dhëna rreth natyrës së thirrjes së Asamblesë, çështjeve që do të trajtohen dhe do të vendosen, vendit, orës dhe datës për mbledhjen e parë dhe të dytë.

13.3 Asambleja mund të mbledhet edhe jashtë selisë së shoqërisë, si në Itali ashtu edhe në Shqipëri.

13.4 Në rastin të mungesës së mbledhjes së Asamblesë në thirrjen e parë për shkak të mungesës së kuorumit të parashikuar në paragrafin 13.7 të këtij Statuti, Asambleja do të mbledhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve me të njëjtin rend dite.

13.5 Lejohet që në mbledhjet e Asamblesë të mbahen edhe Videokonferenca dhe telekonferenca, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit mund të jenë të identifikuar si dhe tu lejohet të ndjekin diskutimet dhe të ndërhyjnë në kohë reale në trajtimin e çështjeve të paraqitura; duke verifikuar këto kërkesa, që do të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin në të cilin ndodhet Presidenti si edhe Sekretari i Mbledhjes.

13.6 Asambleja konsiderohet e thirrur dhe e mbajtur rregullisht edhe pa respektuar disa nga formalitetet e mbledhjes, nëse është i pranishëm ose i përfaqësuar tërësisht Kapitali i Shoqërisë.

13.7 Vendimet e Asamblesë së Ortakëve, të cilat kërkojnë një shumicë të thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakë me të drejtë vote që përfaqësojnë të paktën 71% (shtatëdhjetë e një përqind) të Kapitalit të Shoqërisë në tërësi. Vendimet e Asamblesë së Ortakëve, të cilat kërkojnë një shumicë të kualifikuar, janë të vlefshme nëse votohen nga ortakët me të drejtë vote dhe që përfaqësojnë të paktën 71% (shtatëdhjetë e një përqind) Kapitalit të Shoqërisë në tërësi.

13.8 Asambleja vendos ndryshimin e Statutit, rritjen dhe zvogëlimin e Kapitalit të Regjistruar, shpërndarjen e fitimit, riorganizimin dhe shkrirjen e Shoqërisë me votat në favor të ortakëve të përfaqësuar të të paktës  $\frac{3}{4}$  e ortakëve, që përfaqësojnë afro 71% (shtatëdhjetë e një përqind) të Kapitalit të Shoqërisë në tërësi.

13.9 Çdo Asamble kryesohet nga një ortak ose nga një person i caktuar nga vetë Asambleja. Për mbajtjen e procesverbalit, Asambleja emëron një sekretar, që mund të mos jetë ortak.

13.10 Vendimet e Asamblesë nënshkruhen nga Presidenti i Asamblesë dhe nga Sekretari.

#### **Neni 14 – Administrimi**

14.1 Administrimi e Shoqërisë i besohet 2 (dy) Administratoreve të cilet do të jenë:

Morisco FRANCESCO dhe Trillo ALFONSO MARCO.

Administratoret kanë kohezigjatje në detyrë 5 (pese) vjet dhe emërohen nga Asambleja me unanimitet.

Administratoret kanë të drejte:

- të tërheqin shuma parash në dorë nga llogaritë bankare të shoqërisë,
- të kryejnë pagesa për transaksionet e zakonshme do të bëhen me çek banke dhe / ose me transfertë bankare nga llogaritë rrjedhëse të kompanisë.
- të delegojnë persona që gezojnë besimin e tyre për llogari të shoqërisë për pagesa të taksave, dhe të shpezimeve të tjera financiare, nepemrjet një procure të apostiluar.

14.2 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i takon Administratoreve. Administratoret ushtrojnë të gjitha kompetencat e tyre në përputhje me gjithçka është parashikuar në Nenin 95 të Ligjit nr. 9901 datë

14/08/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", me përjashtim të sa parashikohet në Nenin pasardhës nr. 14.3.

14.3 Nevojitet një autorizim paraprak i ortakëve, me vendim për tu zbatuar me vota të favorshme të shumicës së ortakëve që përfaqësojnë të paktën 71% (shtatëdhjetë e një për qind) të të gjithë kapitalit të Shoqërisë, për plotësimin e akteve të mëposhtme:

- për marrjen e huave, kredive bankare dhe hapjen e kredive në përgjithësi, pranë instituteve dhe subjekteve financiare, nënshkruan kontrata që kanë si objekt të tyre transaksionet financiare dhe/ose ekonomike, operacionet ekonomike dhe/ose financiare të tipeve të tjera, blerje dhe shërbime, me ose pa garanci

- për shitblerje, për kontribute dhe për qira kompanish ose të degëve të kompanisë;

- për themelimin e shoqërisë të çdo lloji tipi, të konsorciumeve dhe të enteve kolektive të çdo lloji natyre;

- për përfitimin dhe heqjen dorë nga pjesëmarrja në fitime të çfarëdolloji natyre;

- për blerjen, shitjen dhe qiradhënien e pasurive të patundshme dhe /ose të tundshme të regjistruara.

14.4 Administratore e shoqërisë është Znj. Roberta Spada

#### **Neni 15 – Eksperti Kontabël**

15.1 Në rastet kur parashikohet nga Ligji, ose vendoset nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i bilancit dhe i librave kontabël të Shoqërisë i besohet një ose më shumë ekspertëve kontabël të autorizuar.

15.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet në çdo moment sipas modaliteteve të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

#### **KAPITULLI IV**

#### **VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMIT**

#### **Neni 16 – Viti financiar dhe bilanci vjetor**

16.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.

16.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë pranë Regjistrimit Tregtar dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.

16.3 Bilancet vjetore, inventari, raporti i Administratorit dhe eventualisht ai i ekspertit kontabël të emëruar, aprovohen nga Asambleja me shumicën e kërkuar nga Ligji 9901 datë 14.04.2007 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

16.4 Aprovimi i dokumentave lidhur me aktivitetin vjetor, bëhet brënda 120 (njëqind e njëzet) ditëve kalendarike në fund të vitit financiar.

#### **Neni 17 – Fitimi**

17.1 Fitimet neto që rezultojnë në bilancin vjetor u shpërndahen ortakëve në proporcion me vlerën nominale të kuotës të kapitalit zotërues.



17.2 Asambleja vendos gjithashtu për tërheqje të veçanta të fitimit në favor të rezervave të jashtëzakonshme apo për destinacione të tjera, ose mund të realizojë shtyerjen e shpërndarjes së fitimit tërësisht ose pjesërisht në vitet e ardhshme.

## KAPITULLI V

### SHKRIRJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

#### Art. 18- Shkrirja

18.1 Shoqëria shkrihet nëse skadon afati i kohëzgjatjes së parashikuar në Statut ose përpara kësaj skadence në rastet e parashikuara nga ligji ose me vendim të Asamblesë së ortakëve me shumicë, të parashikuar për ndryshimin e Statutit të Shoqërisë.

18.2 Shoqëria nuk shkrihet në rast paaftësie, vdekje ose falimentimi të ortakëve.

#### Neni 19 – Likuidimi

19.1 Në rast shkrirje, Shoqëria shpallet në likuidim.

19.2 për të menaxhuar këtë procedurë Asambleja e Ortakëve emëron një ose disa likuidatorë të cilët do të paraqesin raportin final mbi gjëndjen e aktiveve dhe pasiveve të Shoqërisë lidhur me operacionet e likuidimit dhe të kohës së nevojshme për të çuar në fund likuidimin.

19.3 Në përfundim të procedurës së likuidimit Asambleja e Ortakëve do të vendose për bilancin financiar, për vlefshmërinë e punës së kryer nga likuidatori dhe për përfundimin e procedurës së likuidimit.

19.4 Pas shlyerjes së kreditorëve dhe arkëtimit të kredive, likuiduesi/ët do të shpërndajë të ardhurat përfundimtare nga likuidimi ortakëve në proporcion me vlerën nominale të kuotës zotëruese.

#### Neni 20 – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

20.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin, zbatimin, zgjidhjen e Statutit të kësaj Shoqërie dhe në përgjithësi që mund të lindin ndërmjet partnerëve (me përjashtim të atyre që lidhen me marrëdhëniet personale ose jashtë shoqërisë) ose ndërmjet një ose më shumë ortakëve dhe kompanisë do të kryhen mbi bazën e parimeve miqësore me diskutim të drejtëpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

20.2 Në rast se palët nuk gjejnë një zgjidhje miqësore atëherë kjo zgjidhje do të besohet Gjykatës së Tiranës.

#### Art. 21 – Lingua

21.1 Ky Statut hartohet në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe me përkthimin e bashkangjitur në gjuhën italiane


21.2 Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin lidhur me interpretimin e akteve dhe dokumentave të parashtruara, versioni në italisht do të jetë ligjërish i detyrueshëm.

*Trinone më 30/12/2016*

#### ORTAKET

MORISCO FRANCESCO

  
MORISCO FRANCESCO

*për libe  
Ellegi Linda Malocci*  


TRILLO ALFONSO MARCO

*TRILLO ALFONSO MARCO*  
